



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION**

V.KA.nr.9-6/21

Prishtinë, datë 29.03.2022

KOMISIONI PËR ANKESA I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVOËS - në Kolegjin e përbërë nga Agon Rexhaj – Kryesues i Kolegjit, Edona Sina dhe Luljeta Jashari-Hertica – anëtare, me pjesëmarrjen e Vjollca Ajeti në cilësi të procesmbajtëses, duke vendosur sipas ankesës nr.9-5/21 të datës 10.03.2022, e ushtruar nga Avokati _____ me seli të zyrës në _____, kundër vendimit të Komisionit Diciplinor të Odës së Avokatëve të Kosovës numër V.KD.NR.9-4/2021 i dt. 02.02.2022, në seancën jo publike të mbajtur me datë 29.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **PUSHOHET** procedura dicipline ndaj të paraqiturit av. _____ nga _____
- II. **KOMISIONI PËR ANKESA** duke vendosur sipas detyrës zyrtare, në lëndën ndaj të paraqiturit av. _____ me seli të zyrës në _____, konstaton se është arritur afati i parashkrimit absolut, konform nenit 56 par.1 të Ligjit për Avokatinë, për shkak se nga dita e kryerjes së shkeljes dicipline (14.07.2020) e deri më sot kanë kaluar më shumë se një vit.

A r s y e t i m

Komisioni Diciplinor i OAK-së në seancën dicipline të mbajtur me dt. 02.02.2022, mori vendim me të cilin i paraqituri av. _____, avokat në _____ u shpall përgjegjës, për shkelje të lehtë dicipline e parashikuar nga neni 118 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 lidhur me nenin 121 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 52 par.1 të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit, sipas fletëparaqitjes së av. _____, e sipas detyrës zyrtare të ndjekur nga Prokurori Diciplinor i OAK-së.

Avokati _____ u shpall përgjegjës sepse ka pranuar të autorizohet nga z. _____ në lëndën PKR nr.75/2020, pa e informuar paraprakisht avokatin eksistues të kësaj lënde, avokatin _____ edhe pse ishte në dijeni se klienti në momentin që e kishte autorizuar atë, e kishte autorizuar një avokat tjetër i cili e kishte përfaqësuar në atë lëndë.

Për këto veprime të paraqiturit av. _____ Komisionit Diciplinor i kishte shqiptuar masën dicipline dënim me gjobë në shumë prej 200.00 (dyqindë) euro duke e obliguar në pagesën e shpenzimeve të paushallit të procedurës dicipline në shumë prej 50.00 (pesëdhjetë) euro.

I paraqituri av. _____, në afat ligjor parashtron ankesë, me të cilën nuk e konsideron veten përgjegjës dhe propozon që Komisioni i Ankesave i OAK-së, të ndryshoi vendimin atakuar, dhe të nxjerrë vendim me të cilin lirohet nga përgjegjësia diciplinore.

Komisioni për Ankesa i OAK-së në seancën jo publike të mbajtur me datë 29.03.2022, pas referimit të rastit, shikimit të shkresave të lëndës, duke iu referuar vendimit të atakuar poashtu dhe pretendimeve ankimore sipas ankesës së paraqitur, dhe pas shqyrtimit me kujdes të të gjithave shkresave të lëndës, erdhi në përfundim se lidhur me këtë çështje është arritur afati absolut i parashkrimit për ndjekje diciplinore, konform nenit 56 par.1 1 të Ligjit për Avokatinë i cili parasheh: *"Fillimi i procedurës diciplinore për shkelje të lehta parashkruhet gjashtë (6) muaj pas njoftimit për shkeljen e bërë dhe kryesin, kurse në çdo rast parashkruhet pas kalimit të afatit kohor prej një (1) viti prej ditës së kryerjes së shkeljes"*.

Nga koha e shkeljes diciplinore të pretenduar, e të paraqiturit av. _____, ka kaluar më shumë se një vit, sepse shkelja e pretenduar është kryer me dt. 14.07.2020, dhe e njejta konsiderohet datë e kryerjes së shkeljes së pretenduar diciplinore.

Andaj, Komisioni për Ankesa i Odës së Avokaëve të Kosovës, konform nenit 56 par. 1 të Ligjit për Avokatinë, neneve 38, 43 dhe 44 të Rregullores për Procedurë Diciplinore për Avokatë dhe Praktikantë të OAK-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI I ANKESAVE I ODËS SË AVOKATËVE TË KOSOVËS

Prishtinë, V.KA.nr.9-6/21 të datës 29.03.2022

Kryesuesi i Kolegjit

Av. Agon Rexhaj

